Republika e Kosovës- Repuplika Kosova-Republic of Kosovo
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINSTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Masa 303

"ZBATIMI I STRATEGJIVE ZHVILLIMORE LOKALE-QASJA LEADER"

Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2018

Udhëzues për aplikues

Përmbatja

Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural....1
1. Objektivat, prioritetet dhe masat e skemës së granteve....3
1.1 Historiku....3
1.2 Objektiva e masës 303....4
1.3 Objektivat specifike të masës 303....5
1.4 Mjetet finaciare për masën 303....5
1.5 Përkufizimet kyçe....5
2. Intensiteti dhe lartësia e ndihmës financiare dhe aplikantët e pranueshme....6
2.1 Intensiteti i ndihmës....6
2.2. Aplikantët e pranueshëm....7
2.3 Aktivitetet e pranueshme....7
2.4 Lista indikative e shpenzimeve të pranueshme....7
3. Procedura e aplikimit....8
3.1 Dorëzimi i aplikacionit dhe Afati i fundit....8
3.2 Afati për dorëzim të Aplikacionit....8
3.3 Dorëzimi i aplikacionit....8
4. Përzgjedhja, kontraktimi dhe zbatimi i veprimeve....9
4.1 Procedura e përzgjedhjes....9
4.2 Shënime të rëndësishme për aplikantët lidhur me refuzimin e aplikacioneve....9
5. Procedurat administrative....10
6. Lista e shtojcave....10
Shtojca 1: Lista e dokumenteve të dorëzuara....11
Shtojca 2: Formulari për Aplikim....13
Shtojca 3: Projekt propozimi për GLV-t e përzgjedhura dhe RrZhR të GLV-ve....17
Shtojca 4. Projekt propozimi për GLV-përzgjedhura dhe RrZhR te GLV-ve....21
Shtojca 5: Formulari i Kontratës....23
Shtojca 6: Formulari i Kërkesës për Pagesë për Masën 303.1....28
Shtojca 7: Letra Informuese....34
Shtojca 8: Lista e Shpenzimeve të Pranueshëm....35
Shtojca 9: Treguesit....35

1. Objektivat, prioritetet dhe masat e skemës së granteve

1.1 Historiku

Në periudhën 2007-2009, me iniciativën e MBPZHR-së, janë themeluar 30 Grupe Lokale të Veprimit (GLV) - të cilat mbulojnë të gjithë zonën rurale të vendit - në Kosovë. GLV-të në Kosovë janë organizuar mbi bazën e komunave në këtë mënyrë secilës komunë i korrespondon një GLV. GLV-të janë regjistruar si Organizata jo-Qeveritare (OJQ) në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Gjatë viteve të fundit GLV-të kanë zbatuar/ implementuar projekte të ndryshme për të mirën e komuniteteve të tyre me mbështetje financiare nga MBPZHR, komunat dhe organizatat e tjera donatore. Në mënyrë që të lehtësohet promovimi, komunikimi dhe shpërndarja e informacionit midis GLV-ve dhe akterëve të tjerë rural është themeluar edhe Rrjeti i Zhvillimit Rural (RrZhR). RrZhR është duke funksionuar si një platformë diskutimi për projekt-ide, propozime të ndryshme dhe shkëmbim të përvojave. RrZhR ka statusin ligjor të një Organizatë Jo Qeveritare (OJQ).

Megjithëse të 30 GLV-t formalisht janë të themeluara, më pak se gjysma nga to aktivisht bëjnë promovimin dhe zbatojnë/ implementojnë projekte në zonat e tyre, ndërsa disa të tjera janë me pak ose aspak aktive.
Zbatimi i Masës LEADER dhe i nën-masave të ndërlidhura aktuale, do të jenë të rëndësisë vendimtare për të siguruar mbështetje të mëtutjeshme për ekzistimin e GLV-ve, për përmirësimin e kapaciteteve të tyre në mënyrë që të luajnë rolin e agjentit/promovuesit për zhvillimin e zonave rurale sipas principeve mirë të njohura të qasjes LEADER.

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2014, është realizuar aktiviteti "Ndihmesa teknike për GLV-të e mundshme" në formë të thirrjes për prezantime të Strategjive Zhvillimore Lokale (SZhL). GLV-të është dashur të parashtrojnë strategjitë reja zhvillimore lokale apo t'i përditësojnë/rishikojn ato ekzistueset në mënyrë që të përzgjidhen dhe të kualifikohen për aktivitetet vijuese, të parapara në kuadër të kapitullit LEADER të PBZHR. Thirrja është shpallur nga autoriteti menaxhues i PBZHR (PBZHR-DPZHR/AM) më (6 Qershor 2014), dhe afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve ka qenë më (2 Dhjetor 2014).

Komisioni përzgjedhës është themeluar në dhjetor të vitit 2014. Ky Komision ka qenë i përbërë nga gjithsej 5 anëtarë (3 Dhjetor 2014), duke përfshirë ekspertët nga MBPZHR – Departameti i Politikave të Zhvillimit Rural (DPZHR), Departamenti i Shërbimeve Këshilluese (DSHK), Agjencioni per Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe një ekspert të pavarur që përfaqësonte shoqërinë civile.

Komisioni përzgjedhës ka bërë vlerësim të thukët të 12 SZhL-ve të parashtruara. Vlerësimi është bërë në bazë të kritereve të pranueshmërisë dhe të përzgjedhjes, të identifikuara paraprakisht, ku Komisioni përzgjedhës gjithashtu ka hartuar edhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së SZhL-ve të parashtruara. Procedura e përzgjedhjes ka përfunduar më 11 dhjetor 2014; të gjitha 12 SZhL-të janë konsideruar si të pranueshme te gjitha ato që kishin arritur më shumë pikë sesa minimumi i paraparë (60/100). Rezultati e përzgjedhjes janë përcjelli te Ministri për aprovim të strategjive të cilët janë nënshkruar me 30 Prill 2015 nga Ministri.

Nga analiza e 12 SZhL-ve të parashtruara në dhjetor të vitit 2014 (9, 10 dhe 11 Dhjetor) janë shpërfaqur një numër elementesh interesante, të paraqitura në vijim:

- Të gjitha 12 SZhL-të janë vlerësuar pozitivisht në bazë të kritereve të pranueshmërisë dhe të përzgjedhjes të përcaktuara në dokumentin për masën që është hartuar në përputhje me Udhëzimet EU-IPARD 2014-2020. Të gjitha 12 SZhL-të kanë arritur rezultate më të larta se minimumi i kërkuar.

- Mangësitë e vogla janë analizuar, ashtu siç është cekur më poshtë (vërejtjet e cekura janë të natyrës së përgjithshme dhe nuk i referohen ndonjë SZhL-je specifike)
    - Strategjitë zhvillimore lokale të paraqitura nuk janë plotësisht koherente dhe të ndërlidhura me PBZhR 2014-2020 (kjo ka ndodhur për shkak se PBZhR nuk ka qenë zyrtarisht e miratuar në kohën kur GLV-të kanë hartuar dhe parashtruar SZhL-të e tyre);
    - SZhL-të e paraqitura nuk janë specifike sa duhet. Në veçanti: I) në analizën e kontekstit paraqitet specifika e territorit në kuptimin e ofrimit të të dhënave socio-demografike dhe ekonomike, por nuk theksohen problemet dhe nevojat specifike të sektorit rural sipas prioriteteve dhe II) objektivat e përzgjedhura janë të ndërlidhura vetëm pjesërisht me nevojat specifike të territorit dhe të sektorit të tij rural;
    - SZhL-të nuk janë të përqendruara në një temë specifike, andaj:
      – veprimet/projektet e propozuara specifike të paraqitura shpesh janë vetëm një listë e "gjërave që duhen bërë" dhe II) lidhja mes zbatimit të një veprimi apo projekti dhe arritjes së objektivave – të dalave të deklaruara nuk është evidente, treguesit e rezultateve dhe të ndikimit mungojnë;
    - Konsultimet e realizuara dhe kontributet e dhëna nga partnerët dhe palët me interes gjatë hartimit të SZhL-ve janë raportuar vetëm pjesërisht në dokumentet e paraqitura.

Në janar të vitit 2015, një Grup Punues (GP) i LEADER-it është themeluar përmes një nisme të DPZHR /AM dhe i aprovur nga sekretari i përhershëm. GP-s është e përbërë nga përfaqësuesit e GLV-ve dhe nga Rrjeti i tyre për zhvillimin rural, funksionarët e DPZHR/AM-së, punonjësit e AZHB-s, OJQ-të dhe nga ekspertët privatë.

Përzgjedhja e suksesshme e grupit të parë të 12 GLV-ve pason me realizimin e dy nën-masave të para, të parapara në kuadër të Masës 303.2 Leader "Hartimi dhe zbatimi i strategjive zhvillimore lokale – qasja leader" dhe 303.12. Nënmasa "Përvetësimi i aftësive dhe Nxitja/animimi i banorëve të teritorit të GLV-ve për GLV të përzgjedhura. Nënmasa e tretë (bashkëpunimi) do të fillohet në një fazë të mëvonshme, pasi që GLV-të të jenë mirë të strukturuara, punonjësit e tyre të jenë trajnuar dhe banorët e territoret e tyre të kenë demonstruar kapacitet për të përfituar nga ato aktivitete.

1.2 Objektiva e masës 303

Qëllimi i aktiviteteve të paraparë është përkrahja e ngritjes së kapaciteteve të GLV-ve të përzgjedhura, anëtarëve të GLV-ve dhe banorëve rural me qëllim të rritjes së shkathtësive të tyre në fushën e demokracisë dhe zhvillimit lokal, si dhe të inkurajimit të tyre në avancimin e nismave dhe partneriteteve lokale. Për më tepër, që të lehtësohet ndërveprimi mes palëve me interes me qëllim të ofrimit të informatave dhe të avancimit të strategjisë e të përkrahjes së përfituesve të mundshëm në zhvillimin e punëve dhe në përgatitjen e aplikacioneve. Po kështu, GLV-të do të jenë në gjendje të kenë strukturë dhe staf të përhershëm.

1.3 Objektivat specifike të masës 303

- Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhuar sipas qasjes LEADER;
- Ndërtimi i kapaciteteve të GLV-ve të përzgjedhuar;
- Vetëdijësimi i popullatës rurale në aktivitetet e GLV-ve përzgjedhuar
- Zbatimi I SZHL-ve (projekteve)

Shkëmbimi i përvojave dhe mësimet e mësuara në mes të GLV-ve të përzgjedhura.

MASA 303, LEADER përbehet nga tri aktivitete kryesore:

.Aktiviteti 1."Pervetesimi I aftesive dhe nxitja e banoreve ne territoret e GLV-ve te perzgjedhura"

-Aktiviteti 2 " Hartimi dhe zbatimi I strategjive te zhvillimit local qasja LEADER – per GLV-te e perzgjedhura dhe

-Aktiviteti 3. " Kooperimi / bashkepunimi " I cili do te fillohet ne nje faze te mevonshme, pasi qe GLT-te te jene mire te strukturara, punonjesit e tyre te jene trajnuar dhe banoret ne territoret e tyre te kene te kene demonstruar kapacitet per te fituar nga ato aktivitete.

1.4 Mjetet finaciare për masën 303
Ndarja e buxhetit sipas aktiviteteve

Aktiviteti 1."Pervetesimi I aftesive dhe nxitja e banoreve ne territoret e GLV-ve te perzgjedhura"

-Aktiviteti 2 " Hartimi dhe zbatimi I strategjive te zhvillimit local qasja LEADER – per GLV-te e perzgjedhura per vitin 2018 eshte 300 000 €.

Masa 303	Buxheti %	Buxheti në €
Aktiviteti 1. "Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve në territoret e GLV-ve"	30%	Për komuna prej 10,000-50,000 banor deri në 5,000euro; Për komuna prej 50,000 –90,000 banor deri në 7,000 euro; Për komuna prej 90,000-150,000 banor deri ne 9,000 euro Për Rrjetin e Zhvillimit Rural 7,000 Euro
Totali		***89,000 euro***
Aktiviteti 2. "Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal "		
Aktiviteti 2a: "Funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura "duke i mbështetur shpenzimet operative të tyre.	26%	*78,480 euro*
Aktiviteti 2b: Aktiviteti i dytë është "Përkrahja për zbatimin e SZhL-ve të GLV-ve"	44%	*132,520 euro*
Totali Buxhetit për GLV dhe RrZhR		***300,000 euro***

Aktiviteti 1 "Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territorit të GLV-ve për GLV-të e përzgjedhura"

Nën-masa do të ketë tri pragje të shpenzimeve maksimale të pranueshme varësisht nga numri i banorëve të territorit që përfshinë GLV-ja e përzgjedhur.

Në bazë të raportit të Agjencisë të Statistikave të Kosovës, Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës, 2013 nëpër komuna ku GLV-të janë përzgjedhur është si vijon:

Për komuna prej 10,000 deri në 50,000 banorë, maksimumi i shpenzimeve të pranueshme për nën-masën 303.1. "Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territorit të GLV-ve për GLV të përzgjedhura shpenzimet e pranueshme janë deri në 5,000 euro:

- Deçan
- Obiliq
- Viti
- Shtime

Për komuna me mbi 50,000 deri në 90,000 banorë, maksimumi i shpenzimeve deri në 7,000 euro:

- Mitrovica
- Skenderaj;
- Rahovec
- Lipjan
- Malishevë

Për komuna me mbi 90,000 deri në 150,000 banorë, maksimumi i shpenzimeve deri 9,000 euro:

- Prizren;
- Ferizaj dhe
- Peja

Dhe për RrZhR deri në 7,000 euro.

1.5 Përkufizimet kyçe

Grupi Lokal i Veprimit (GLV) – është pjesë e strukturës shoqërore e zonës sipas parimit nga poshtë-lartë;
Rrjeti i Zhvillimit Rural (RrZhr) – është struktur menaxhuese e përbërë nga përfaqësuesit e GLV-ve;
Strategjia e Zhvillimit Lokale (SZhL) – është strategjia e zhvillimit lokal të një territori të caktuar
Intensiteti i ndihmës – është pjesëmarrja (e shprehur në përqindje) e mjeteve publike në shpenzimet e pranueshme;

Aplikacion – dorëzimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara në Agjencionin e Pagesave; Thirrja për aplikim – njoftimi publik për pranimin e aplikacioneve;
Kontrata – nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të aplikantit të përzgjedhur dhe Agjencionit të Pagesave, sipas modelit të paapërgatitur, shih Shtojcën nr.4
Shpenzimet apo investimet e pranueshme – janë shpenzimet apo investimet që përkrahen me mjete publike, shih Shtojcën nr.8
Grant – ndihma financiare e pakthyeshme e dhënë nga Agjencioni i Pagesave për shpenzimet e pranueshme;
Autoriteti Menaxhues – entitet publik brenda MBPZHR i organizuar si Departament me përgjegjësi kryesore në hartimin dhe monitorimin e Programit;
Masa – dokument teknik që paraqet njësinë bazë të Programit dhe pjesët kryesore të saj janë kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve. Masa ka buxhetin e saj përmes të cilit synohet të arrihet ndikim i caktuar. Masa zbatohet përmes thirrjes për aplikim dhe procesit të vlerësimit të projekteve.

Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë është Agjencion i Pagesave (http://azhb.rks-gov.net/) me përgjegjësi kryesore në vlerësimin dhe kontraktimin e projekteve si dhe pagesën e shpenzimeve sipas procedurave të parapara;
Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2017 – është dokument teknik i përbërë i cili përcakton masat e zhvillimit rural, logjikën e intervenimit dhe ndikimin e pritur të granteve;
Projekt – investimi i planifikuar i dorëzuar nga aplikanti;
Periudha e implementimit të projektit – koha prej nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri te ekzekutimi i pagesës së fundit nga AZHB;
Përzgjedhja – përcaktimi i numrit të pikëve për aplikantët e pranueshëm, radhitja e tyre në listë sipas pikëve dhe deklarimi i tyre „i përzgjedhur për financim" dhe shpërndarja e mjeteve financiare duke filluar nga ata në krye të listës.

2. Intensiteti dhe lartësia e ndihmës financiare dhe aplikantët e pranueshëm

2.1 Intensiteti i ndihmës

Aktiviteti 2. "Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale"

a) Aktiviteti 2a është funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhuara duke i mbështetur shpenzimet operative të tyre.

Aktiviteti 1. "Përvetësimi i aftësive dhe nxitja/animimi i banorëve të teritorit të GLV-ve për GLV të përzgjedhura''.

GLV–të e përzgjedhura pas nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, 80% e të gjitha shpenzimeve të pranueshme i marrin si paradhënie.

Ndërsa pas përfundimit të projektit, përfituesi duhet të sjellë dëshmi (faturat, timesheet ose formularin e ditëve të punës të menaxherit dhe të ekspertëve, si dhe CV e menaxherit, CV e ekspertit etj. procedura si është zgjedhur menaxheri apo eksperti), si për para të marruara në avans ashtu edhe për 20% të cilat paguhen pas përfundimit të projektit. (pas kontrollës së dytë në terren, përllogaritjes së faturave dhe rezultateve të investimit) Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti, përfituesi (GLV-ja e kontraktuar) obligohet të kthej mjetet e marrura.

Vërejtje: Këtu intensiteti i ndihmës nga MBPZHR është 100% për GLV-të e përzgjedhura.

Aktiviteti 2. "Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale"

Aktiviteti 2b që është zbatimi i SZhve të GLV-te e përzgjedhura ku promovojnë dhe zbatojnë projekte te vogla në përputhje me SZHL.

Përzgjedhja e projekteve nga GLV-te dhe procedurës së aplikimit

GLV-të të përzgjedhura zbatojnë programin sipas qasjes prej poshtë-lartë. Vendimet lidhur me elaborimin dhe zbatimin e strategjive zhvillimore lokale duhet të merren nga bordi kryesues i GLV-së përmes shumicës së thjeshtë të votave.

GLV-ja duhet të përgatisë (dhe të përzgjedh projektin) mandej aplikacioni përcjellët në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB).

GLV–të e përzgjedhura pas nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, 80% e të gjitha shpenzimeve të pranueshme i marrin si paradhënie.

Ndërsa pas përfundimit të projektit, përfituesi duhet të sjell dëshmi (faturat, timesheet ose formularin e ditëve të punës të menaxherit dhe të ekspertëve, si dhe CV e menaxherit, CV e ekspertit etj. procedura si është zgjedhur menaxheri apo eksperti), si për para të marruara në avans ashtu edhe për 20% të cilat paguhen pas përfundimit të projektit. (pas kontrollës së dytë në terren, përllogaritjes së faturave dhe rezultateve të investimit). Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti, përfituesi (GLV-ja e kontraktuar) obligohet të kthej mjetet e marrura.

Vërejtje: Këtu intensiteti i ndihmës nga MBPZHR është 80% dhe 20 % nga donatorët tjerë apo nga anëtarët e GLV-ve të përzgjedhura.

Ndihma publike nga MBPZHR (80%) jepet në dy këste: 80% si paradhënie dhe 20 % pas përfundimit të projektit.

GLV-te dhe RrZhR-ja duhet te bejne kerkesen per pagese edhe per paradhenje.

2.2. Aplikantët e pranueshëm

Përfituesit përfundimtar/final të Aktivitetit 2. "Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale" dhe Aktiviiteti 1. "Përvetësimi i aftësive dhe nxitja/animimi i banorëve të teritorit të GLV-ve për GLV-të e përzgjedhura" **janë të gjitha GLV-të përzgjedhura dhe RrZhR i GLV-ve.**

2.3 Aktivitetet e pranueshme

- Përgatitja e studimit për zonën (psh: studime socio-ekonomike, regjionale, të marketingut, etj.);
- Trajnimi dhe shkollimi/edukim i punonjësve dhe anëtarëve të GLV-ve në bazë të temave të ndryshme:
- Temat e ndërlidhura me qasjen LEADER (psh: koncepti LEADER, qeverisja lokale, SZhL, menaxhimi i rrjeteve, avancimi i pjesëmarrjes së palëve me interes, etj.)
- Temat e ndërlidhura me menaxhimin (psh: përgatitja e planeve të biznesit, përgatitja e aplikacioneve për projekte, kontabiliteti dhe raportimi, etj.);
- Tërheqja e interesimit, organizimi i publicitetit dhe materialet e ngjarjet promovuese për anëtarët e GLV-ve dhe banorët e zonës (p.sh: seminare, punëtori, mbledhje, etj.);
- Pjesëmarrja e anëtarëve të GLV-ve në seminare, punëtori, mbledhje, vizita studimore, duke përfshirë ngjarjet e organizuara nga Rrjeti për Zhvillim Rural.

2.4 Lista indikative e shpenzimeve të pranueshme

- Shpenzimet për hapjen e zyres/funksionalizmin GLV-ve të përzgjedhura, gjegjesisht shpenzimet operative (qiraja e zyres, paga e menaxherit te zyres, mobilim dhe pajisja me kompjuter, printer, telefon, projektor), shpenzimet e shërbimeve publike (rryma, uji, mbeturinat, shpenzimet e telefonit);

- Shpenzimet e shërbimeve të ekspertëve me CV të verifikuar (ekspertet te zhvillimit ekonomik, rural dhe regjional, mjedisit, marketingut);
- Shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë;
- Shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë Kosovës, duke përfshirë akomodimin dhe mëditjet; (anëtarëve të GLV-ve të përzgjedhura);
- Shpenzimet lidhur me aktivitetet e nxitjes, animimit të interesimit (p.sh.: trajnimet, pjesëmarrja në seminare, punëtori dhe panaire, parapagimi për publikime dhe blerja e tyre, aktivitete të tjera të zgjimit të interesimit, etj.);
- Shpenzimet e organizimit të punëtorive dhe ngjarjet informative për nxitjen/animimin e pjesëmarrjes aktive të popullatës rurale ne procest e zhvillimit lokal;
- Shpenzimet e marrjes me qira të objekteve dhe pajisjeve për organizime të ndryshme, si dhe shërbimet hoteliere;
- Shpenzimet për përgatitjen dhe publikimin e materialeve promovuese, duke përfshirë
- Shpenzimet për ngjarje kulturore (panaire, festivale ekspozita etj). Promovim produkteve vendore (etiketim, marketing, fletëpalosje, shenjëzim i rrugëve malore etj) infrastrukturë të shkallës së vogël (gardh, fontanta, parqe, ura te vogla, rrugë fushore, rinovim të trashigimisë kulturore dhe natyror etj).

3. Procedura e aplikimit

Pas kompletimit të dokumenteve të kërkuar shih në Shtojca nr 1. Dokumentet e kërkuara për aplikacione.

Aplikimi bëhet në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë,

Rruga Migjeni

10000 Prishtinë, Kosovë

3.1Dorëzimi i aplikacionit dhe Afati i fundit

Kur?

Thirrja për Aplikim bëhet nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë dhe njoftoim do të publikohet në faqen e internetit të MBPZHR: http://www.mbpzhr-ks.net/ dhe në faqen e internetit të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë http://azhb.rks-gov.net

3.2 Afati për dorëzim të Aplikacionit

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 40 ditë nga data e publikimit ne gazetën ditore, për GLV-t e përzgjedhura dhe për RrZhR.

3.3 Dorëzimi i aplikacionit

Aplikacionet së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara - duhet të dorëzohet vetëm brenda periudhës së përmendur në kuadër të shpalljes.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë nuk e pranon aplikacionin. Aplikanti ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që të kompletoj dokumentet.

Nëse nuk plotësohen këto kushte brenda afatit të parapara, projekti refuzohet.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, në adresën e tyre shënuar në kuadër të

Zyrën e Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë në Rr: Migjeni (ish Banka e Lublanës kati 7).

10 000 Prishtinë.

Për informata më të hollësishme vizitoni web faqen www.azhb-ks.net, si dhe udhëzuesin për aplikues.

4. Përzgjedhja, kontraktimi dhe zbatimi i veprimeve

4.1 Procedura e përzgjedhjes

Përzgjedhja e përfituesve të mundëshme bëhet sipas kritereve të pranueshmërisë dhe kritereve të kontrollës administartive dhe të gjithë GLV-të përzgjedhura dhe RrZhR që i plotësoj kushtete e pranueshmërisë dhe kontrollën administarive (dokumentete e kërkuara dhe projket propozimin sipas formës se publikuar në udhëzues) të jenë përfitues potencial .

4.2 Shënime të rëndësishme për aplikantët lidhur me refuzimin e aplikacioneve

Aplikacionet mund të refuzohen nese nuk janë të kompletuara, nese nuk e plotesojnë kriterin e pranueshmërisë.

Kujdes: arsyet e refuzimit duhet të paraqiten dhe sqarohen në vendim të cilën Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë ia dërgon Aplikuesit!

2. Aplikacionet e papranueshme – deklarohen të papranueshme vetëm ata të cilët nuk i plotësojne kriteret e pranueshmërise dhe kriteret të kontrollës administrative të cilin e bëjnë zyrtarët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë.

Kujdes: për aplikacionet e pakompletuara aplikanti njoftohet dhe brenda 5 dite prej momentit kur merre informatën duhet të plotësoj.

Mund të thirren vetëm për dokumente (si nr. i letër njoftimit, nr. xhirollogarisë, nr.fiskal)

Nëse nuk plotësohen këto kushte brenda afatit të parapara, projekti refuzohet.

10

5. Procedurat administrative

- GLV-te e përzgjedhura për periudhën 2014 - 2020 dhe RrZHR aplikojnë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë me projekt propozim për mbulimin e kostove operative për funksionalizimin e GLV-ve dhe për ndërtimin e kapacitetetve të GLV-ve.
- GLV e zgjedhura nënshkruajnë kontratë me AZHB (kontrata përcakton të drejtat dhe obligimet e një GLV-je) në përputhje me rregullat e vendosura.
- AZHB kontrollon GLV-të në lidhje me obligimet që dalin nga kontrata (kontrollin administrativ dhe kontrollin në vend).
- AZHB ekzekuton pagesat për GLV në bazë të kërkesave të kontrolluara dhe të miratuara për pagesës.

6. Lista e shtojcave

1. Shtojca 1: Lista e dokumenteve të dorëzuara
2. Shtojca 2: Formulari për Aplikim
3. Shtojca 3: Projekt propozim per GLV- potenciale dhe RRZhR/ për Aktivitetin a " Funksionalizimi i GLV të përzgjedhura "
4. Shtojca 4: Projekt propozimi për GLV-përzgjedhura dhe RrZhR të GLV-ve/ Për Aktivitetin 1. "Përvetësimi i aftësive dhe nxitja/animimi i banorëve të teritorit të GLV-ve për GLV të përzgjedhura"
5. Shtojca 5: Formulari i Kontratës
6. Shtojca 6: Formulari i Kërkesës për Pagesë për Masën 303
7. Shtojca 7: Letra Informuese
8. Shtojca 8: Lista e Shpenzimeve të Pranueshëme
9. Shtojca 9: Treguesit

Shtojca 1: Lista e dokumenteve të dorëzuara

Dokumentet e kompletuara (dosja) duhet ti ketë dokumentet e radhitura si në listën e mëposhtme dhe çdo faqe duhet të ketë të shkruar numrin (me dorë). Ky numër duhet të paraqitet në listë pranë emrit të dokumentit.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin, por e regjistron aplikantin dhe i jep atij një kopje të kësaj shtojce duke ja rrumbullakësuar dokumentet që i mungojnë aplikantit. Aplikanti ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që të kompletoj dokumentet.

Në rastet kur kërkohet vetëm kopje e dokumentit, aplikanti e shkruan me dorë në kopje „sikur në origjinal"dhe ja sjellë origjinalin në shikim zyrtarit regjional i cili verifikon përputhshmërinë e kopjes dhe ja kthen origjinalin aplikantit

Për GLV-përzgjedhura

Dokumentet e bashkangjitura /ju lutem shënoni me * / ✓ / (dhe radhitni ato sipas listës së dhënë në fund të këtij aplikacioni	Obligative
Formularin për Aplikim - sipas modelit të AZHB-së preferohet të jetë i plotësuar me makinë ose kompjuter. Shih Aneksi nr. 2	☐
Aplikanti/GLV-përzgjedhur duhet të paraqesë një projekt propozimin) Shih Aneksi nr.3	☐
Dëshmin se trupi meanxhues i GLV-s së përzgjedhur prezenton intresat e grupeve të ndryshme publik dhe privat (lista e anëtarëve të trupit meanxhes)	☐
Mbi 50% të anëtarëve duhet të jenë anëtarët që paraqesin partneret ekonimik, sociale, shoqërin civile asociacione, shoqata të ndryshme që mbulojn atë teritor. (lista e anëtarëve dhe nga vinë institucioni, organizata, kompania private etj)	☐
Jo më pak se 20% të jenë anëtarë që vinë nga institucionet publike (lista e anëtarëve)	☐
Respektimi i diversiteteit të moshë dhe barazia gjinore më së pak 10 % të anëtarëve të jenë femra dhe të rinj. (lista e anëtarëve si dhe të paraqitete mosha e tyre, gjinia (data e lindjes)	☐
Certifikatën e regjistrimit të GLV-s përzgjedhur në Regjistrin e OJQ-ve, ne Ministrinë e Administratës Publike	☐
Kopje e letër njoftimit të përfaqsuesit të autorizuar nga GLV-s. Përzgjedhur	☐
Dëshmin e xhirrollogarisë bankare në emër të përfaqsuesit të GLV-s -përzgjedhur	☐
Certifakën e numëri Fiskal të GLV-s - përzgjedhur Dëshmia e kryrejes së obligimeve të antarësisë ndaj RrZhR-se	☐

12

Për RrZhR

Dokumentet e bashkangjitura /ju lutem shënoni me * / ✓ / (dhe radhitni ato sipas listës së dhënë në fund të këtij aplikacioni	Obligative
Formularin për Aplikim - sipas modelit të AZHB-së preferohet të jetë I plotësuar me makinë ose kompjuter. Shih Ankesin nr.2	☐
Aplikanti/RrZhR duhet të paraqesë një projekt propozimin Shih Aneksin nr.3	☐
Certifikatën e regjistrimit të RrZhR në Regjistrin e OJQ-ve, ne Ministrinë e Administratës Publike	☐
Dëshmin se menaxheri (udhëheqsi i RrZhR) ka eksperincë në zhvillim rural/ Diploma e fakultetit dhe CV	
Kopje e letër njoftimit të përfaqsuesit të autorizuar nga RrZhR.	☐
Dëshmin e xhirrollogarisë bankare në emër të përfaqsuesit të RrZhR.	☐
Certifakën e numëri Fiskal të RrZhR.	☐
	☐

Shtojca 2: Formulari për Aplikim

FORMULARI PËR APLIKIM MASA 303: Përkrahje për GLV të përzgjedhura dhe RRZhR	
I. Emri i përfituesit	…… (Subjekti juridik dhe emri i personit kontaktues) …… (Komuna)
	Regjioni:
	Komuna:
	Vendbanimi:
	Nr. i rrugës:
	Fahu postar:
	Telefoni
	Faksi
	E-mail
	Ueb faqja
II. Emri i GLV -s	…… …… ……
Vetëm për përdorim zyrtar (të plotësohet nga shërbyesi civili i AZHB-së):	
Numri unik regjistrues i projektit (NUR): ……..…….	

III. Data:	_____ (dd/mm/vvvv)
IV. Koha:	_____ (ora dhe minuta, të plotësohet vetëm kur aplikacioni të jetë komplotuar)
V. Aplikacioni është	**PO** **JO**

komplotuar	
Vetëm për përdorim zyrtar (të plotësohet nga zyrtaret te AZHB-së):	

_____ _____

(nënshkrimi i aplikuesit) (nënshkrimi i zyrtarit të AZHB)

VI. Përshkrimi i aplikantit		
Për Personat (entitetet) Juridike GLV:		
Numri Regjistrues i GLV-së		
Statusi Juridik		
Për të gjithë aplikantët:		
Banka	Emri i bankës:	
	IBAN:	
	Xhirrollogaria e bankës	
	Adresa:	
Personi i fizik apo i Autorizuar		
Emri …… … **Emri i Babës** …… … **Mbiemri** …… ….	Numri i Identifikues	
	Nr. i kartës së Identifikimit	
	E-mail:……..	
VII. Numri i projekteve të mbështetura nën këtë masë .		

GLV ka marrë mbështetje në kuadër të kësejë mase	**Po** **Jo**
Numri i projekteve të mbështetura më parë	
GLV-ja aplikoj për mbështetje në kuadër të kësejë mase	Për _____ kohë

IX. Përshkrimi i mbështetjes së marrë financiare	
Mbështetja e parë financiare e marrë në kuadër të kësejë mase	……Euro Nr. i Kontratës _____/_____(data)
Mbështetja e dytë financiare e marrë në kuadër të kësajë mase	……Euro Nr. i Kontratës _____/_____(data))
Shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare të marrë në kuadër të kësajë mase deri më tani:	…… Euro

X. Deklaratat
Duke firmosur këtë formular për aplikim, **Unë deklaroj, se**: Të gjitha të dhënat, informatat dhe dokumentacionin, të cilin unë kam paraqitur në këtë formular për aplikim janë të vërteta. ***GLV obligohet se do të:*** Shfrytëzoj investimet konform projektit të dorëzuar me aplikacion (dhe të mos shes, financoj, heqë dorë nga ato); Të bëjë kthimin e grantit të pranuar nëse nuk veproj në përputhje me kushtet e kontratës:
XII. Data / Nënshkrimi

Data – muaji – viti ……/……/……..	……..……..……/…… ……. (Emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Vërejtje: përfituesi plotëson vetëm fushat e bardh

Shtojca 3: Projekt propozimi për GLV-t e përzgjedhura dhe RrZhR të GLV-ve

A. Model për projekt propozim për GLV të përzgjedhura për Aktivitetin 2. "Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale"

Aktiviteti 2a – "Funksionalizimi i GLV të përzgjedhura "

Për: Grupe Lokale të Veprimit të përzgjedhura

1. Informata të përgjithshme

1.1 Grupi Lokal i Veprimit Përzgjedhur, adresa, regjistrimi dhe të dhënat për kontakt të zyrës operative

1.2 Përshkrim i shkurtër Roli i Grupit Lokal të Veprimit

1.3 Bordi menaxhues dhe trupa udhëheqëse me nominim nga përsoni përgjegjës.

a) Trupi menaxhus i GLV- ve të përzgjedhur duhet të jetë i përbërë në atë mënyrë që ta paraqes interesat e grupeve të ndryshme publike dhe private të popullatës në zona rurale.

1.4 Numri i anëtarëve më shumë se 50% duhet të jenë partnerët që përfaqësojn shoqërin civile, partnerët ekonomike, shoqatat e ndryshme që veprojn në atë territor.(lista e anëtarëve dhe nga vinë institucioni, organizata, kompania private etj)

1.5 Minimumi duhet të jenë 20% e anëtarëve nga institucionet publike (më pak se 50%)

